



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .07.2025

MBLEDHJA Nr. 28,
Datë 08.07.2025, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 08.07.2025, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 28 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP”.
2. Mbi miratimin e “Udhëzimeve për Testimin e Tregut” për gazsjellësin Trans Adriatik.
3. Mbi shqyrtimin e kërkesës së TAP AG për moszbatimin e “Standartit ISO 27001”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNPRO ” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Qershor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
6. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Një Udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI